VENDIM
Nr.570, datë 8.12.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.200, DATË 22.4.1999, "PËR DISA NDRYSHIME NË PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË PYJORE DHE POLICISË SË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 54 e 56, të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992, "Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor", si dhe të nenit 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetecat për caktimin e pagave të punës', me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja "b" e pikës 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.200, datë 22.4.1999, ndryshohet dhe formulohet si vijon:

"Niveli më i ulët i pagës së ushtarakut të shërbimit pyjor të jetë 6 380 (gjshtëmijë e treqind e tetëdhjetë) lekë në muaj, kurse niveli më i lartë, drejtor drejtorie, të jetë 20350 (njëzet mijë e treqind e pesëdhjetë lekë në muaj".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta